

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
MIDIS MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME DHE
TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR
TË REPUBLIKËS SË ITALISË
MBI
FUNKSIONIMIN E SEKSIONEVE SHKOLLORE DYGJUHËSHE
SHQIPTARO-ITALIANE

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Italisë, të quajtura më poshtë “Palë”,

DUKE IU REFERUAR	nenit 4 të Marrëveshjes për Bashkëpunimin Kulturor të datës 12 shtator 1994 midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Italiane;
------------------	---

DUKE IU REFERUAR	Memorandumit të Mirëkuptimit të datës 29 prill 1998 midis Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Italisë;
------------------	--

DUKE PASUR PARASYSH	përvojën e fituar nga funksionimi i shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe, përkatësisht shkollave 9-vjeçare “Pandeli Cale” dhe “Sevasti Qiriazi” në Korçë, shkollave 9-vjeçare “Ndre Mjeda” e “Ismail Qemali” në Shkodër dhe shkollave 9-vjeçare “E Kuqe” dhe “Pjeter Budi” në Tiranë, dhe të seksioneve dygjuhëshe në gjimnazet “Themistokli Gërmenji” në Korçë, “28 Nëntori” në Shkodër dhe “Ismail Qemali” në Tiranë;
---------------------	---

DUKE KONSIDERUAR	interesin e përbashkët për arsimim të nivelit të lartë që të sigurojë përgatitjen e nxënësve të aftë të ndjekin me sukses studimet në universitetet shqiptare ose italiane dhe të bëhen lehtësues në raportet midis dy shteteve dhe në kuadrin e procesit të integritetit evropian të Shqipërisë;
------------------	---

DUKE KONSIDERUAR	Memorandumin e Bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të
------------------	--

Jashtme italiane të firmosur më 14 janar 2011 dhe
Adendumit të tij më 7 korrik 2011,

kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme mbi funksionimin e seksioneve shkollore
dygjuhëshe dhe dykulturore shqiptaro-italiane:

NENI 1

Veçantitë e seksioneve dygjuhëshe, kohëzgjatja dhe vendndodhja

Modeli i mësimdhënies së seksioneve shqiptaro-italiane është dygjuhësh dhe dykulturore. Mësimdhënia në shkollat mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe shqiptaro-italiane nga klasa III deri në klasën IX (shtatë vjet) të arsimit bazë parashikon mësimdhënien/mësimnxënien e gjuhës italiane me tri orë në javë. Modalitetet e regjistrimit dhe të pranimi të nxënësve në klasat përkatëse të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe përcaktohen nga Pala shqiptare. Mësimdhënia në seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane nga klasa X deri në klasën XII të arsimit të mesëm të lartë (tre vjet) parashikohet mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë italiane si dhe e lëndëve të tjera në gjuhën italiane të detajuara në nenin 4. Seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane janë ekuivalente me gjimnazin shqiptar dhe funksionojnë në gjimnazet përkatëse në Tiranë, Korçë e Shkodër, si në shtojcën "E" të këtij Memorandumi.

NENI 2

Kriteret e pranimi në seksionet dygjuhëshe në klasën X

Regjistrimi në klasën X varet nga rezultatet përfundimtare të klasës IX të arsimit bazë dhe mundësitë e secilës shkolle. Klasa e seksionit ka 30 nxënës.

Në rastet kur kërkesat për regjistrim në klasën X janë më të mëdha se 30 nxënës për klasë si kriter për regjistrimin e tyre do të përdoret niveli i njohjes së gjuhës italiane dhe nota mesatare e klasës paraardhëse.

Ka përparësi regjistrimi nxënësve që vijnë nga klasa IX e Seksioneve Dygjuhëshe në arsimin bazë.

Niveli i njohjes së gjuhës italiane për pranimin në klasën X është niveli B1, sipas Kuadrit të Përbashkët European të Referencës për Gjuhët (Shkalla Globale). Orët e mësimi në klasë do të integrohen me aktivitete ekstrakurrikulare.

NENI 3

Plani mësimor dhe programet lëndore

Në tri vitet e gjimnazit parashikohet mësimi në gjuhën italiane i lëndëve:

1. Gjuhë dhe letërsi italiane;
2. Matematikë;
3. Fizikë;
4. Histori dhe njohuri të historisë së arteve;
5. Biologji.

Niveli i njohjes së gjuhës italiane, që duhet të arrihet në fund të 10 viteve të studimit, është niveli C1, sipas Kuadrit të Përbashkët European të Referencës për Gjuhët (Shkalla Globale).

Plani mësimor dhe programet për lëndët e veçanta miratohen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Shqipërisë dhe nga Ministria e Arsimit, Universiteteve dhe e Kërkimit e Italisë dhe përbëjnë shtojcën A (plani mësimor me koeficiente) dhe shtojcën B (programi i lëndëve) të këtij Memorandumi.

Në shtojcën A të Memorandumit të Bashkëpunimit gjendet plani mësimor i seksionit me orët javore dhe koeficientët.

Në shtojcën B të Memorandumit të Bashkëpunimit gjenden programet e lëndëve në gjuhën italiane: Gjuhë dhe Letërsi italiane, Histori dhe njohuri të historisë së arteve si dhe programet bazë e të thelluara të Matematikës, Fizikës dhe Biologjisë.

Lëndëve që zhvillohen në gjuhën italiane u aplikohet një koeficient prej 1,3 në përlllogaritjen e notës përfundimtare të secilës lëndë në përfundim të çdo viti shkollor.

Plani mësimor dhe programet e secilës lëndë për çdo vit shkollor mund të ndryshohen ose të plotësohen në takimet e specialistëve të thirrur nga njëra prej Palëve.

Ndryshimet dhe/ose plotësimet do të zbatohen në vitin shkollor që fillon pas miratimit.

NENI 4

Matura Shtetërore: hartimi, vlerësimi dhe komisioni i provimeve

Kohëzgjatja e studimeve në seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përfundon me provimet e Maturës Shtetërore, të cilat përcaktohen sipas akteve ligjore të sistemit arsimor shqiptar.

Provimet e detyruara të Maturës Shtetërore janë:

- Gjuhë dhe letërsi shqiptare;
- Gjuhë dhe letërsi italiane me shkrim e gojë (niveli C1);
- Matematikë me shkrim në gjuhën italiane.

Krahas provimeve të detyruara ka dhe një provim me zgjedhje të detyruar. Nxënësit zgjedhin cilëndo lëndë midis atyre që studiojnë në gjuhën shqipe dhe italiane, përveç pjesës “njohuri të historisë së arteve” në gjuhën italiane.

Testet për lëndët në gjuhën italiane, si për lëndët e detyruara dhe për lëndët me zgjedhje, përgatiten nga Ministria e Arsimit, Universiteteve dhe Kërkimit Shkencor të Italisë.

Vlerësimi i çdo provimi me shkrim dhe me gojë kryhet sipas procedurave të parashikuara në sistemin e vlerësimit në Republikën e Shqipërisë (sistemi me dhjetë nota, ku nota 4 është jokaluese, kurse nga nota 4,5 e lart vlerësimi është kalues).

Ekuivalentimi i notave sipas sistemit italian do të kryhet sipas kriterëve të paraqitura në tabelën e përgatitur nga Zyra përkatëse e Ministrisë së Arsimit, të Universiteteve dhe e Kërkimit Shkencor të Italisë (shtojca C).

Komisioni i vlerësimit të provimeve të Maturës Shtetërore krijohet sipas kriterëve që parashikon legjislacioni për sistemin arsimor shqiptar me pjesëmarrjen edhe të mësuesve italianë të lëndëve që zhvillohen në gjuhën italiane.

Gjatë zhvillimit të provimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë ka fuqinë për të emëruar një vëzhgues me funksione mbikëqyrëse.

NENI 5

Dokumenti përfundimtar dhe regjistrimi në universitet

Dokumenti përfundimtar, Diploma e Maturës Shtetërore, lëshohet nga autoritetet shqiptare dhe është i vlefshëm për regjistrimin në Institucionet e Arsimit të Lartë. Diploma e Maturës Shtetërore, e shoqëruar me certifikatën e vlefshmërisë, të lëshuar nga Ambasada Italiane ose nga Konsullata Italiane në Shqipëri, është e vlefshme për regjistrimin në universitetet italiane. Në këtë rast, nxënësi nuk jep provimin e gjuhës italiane. Në rastet kur pranimi në universitetet italiane është me kuota të përcaktuara, kandidatët duhet të kryejnë procedurat e caktuara të pranimit.

NENI 6

Mësuesit

Personeli mësimdhënës i angazhuar në seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane sipas planit mësimor dhe planifikimit vjetor bashkëlidhur, përbëhet nga mësues shqiptarë dhe italianë. Pala italiane dërgon brenda mundësive të saj financiare tre mësues për çdo seksion për lëndët:

1. Gjuhë italiane në shkollën 9-vjeçare;
2. Gjuhë dhe letërsi italiane dhe Histori në shkollën e mesme;
3. Matematikë dhe fizikë në shkollën e mesme.

Mësuesit italianë janë pjesë e trupës mësimore të secilës shkollë dhe së bashku me mësuesit shqiptarë përgjigjen për zhvillimin e mësimdhënies dhe vlerësimin për lëndët të cilat do të japin. Ata, së bashku me mësuesit shqiptarë, bashkërendojnë punën mësimore-edukative vjetore.

Mësimdhënia në seksionet dygjuhëshe zhvillohet në grupe ose në modelin e bashkëmësimdhënies çka jep mundësinë që klasa të ndahet në dy grupe për të bërë të mundur zhvillimin e mësimdhënies të fokusuar në pjesë të vecanta duke përdorur metodologji të shumta si frontalisht në klasë, si në laboratorë.

Mësuesit italianë dhe shqiptarë të të njëjtës lëndë punojnë në bashkëprezencë vetëm në rastet e periudhës së prezantimeve të projekteve, të përsëritjes së përgjithshme dhe në vlerësimin e nxënies.

Emërimi i mësuesve të rinj shqiptarë për seksionet bëhet në bazë të procedurave shqiptare me miratimin e Zyrës së Shkollave të Ambasadës së Italisë.

NENI 7

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve

Pala italiane, brenda bilancit financiar të disponueshëm, mbështet funksionimin e seksioneve dygjuhëshe duke siguruar:

- mbështetje financiare për ngarkesën mësimore të gjuhës italiane dhe të lëndëve që jepen në gjuhën italiane;
- pajisje me libra shkollorë, libra për bibliotekat dhe materiale didaktike, multimediale dhe shkencore për laboratorët;
- bursa studimi për kurset verore për perfeksionimin gjuhësor pranë institucioneve të specializuara italiane, lëndor dhe didaktik për mësues shqiptarë që japin italisht ose lëndë të tjera në këtë gjuhë;

- mbështetje financiare për organizimin e kurseve të trajnimit dhe kualifikimit për mësuesit në Shqipëri.

Pala shqiptare për mirëfunksionimin e seksioneve:

- vë në dispozicion godina dhe mjedise të përshtatshme për të bërë të mundur bashkëmbësimdhënien dhe siguron kushtet optimale të punës sipas standardeve të sigurisë europiane në punë. Siguron për mësuesit italianë të seksioneve dygjuhëshe lehtësitë administrative në përputhje me legjislacionin shqiptar e në vecanti në lidhje me lejet e qëndrimit falas.
- njeh dhe vlerëson kreditet e kurseve të kualifikimit për mësuesit të organizuara nga Pala italiane.

NENI 8

Periudha tranzitore

Në seksionet dygjuhëshe zbatimi i reformës së sistemit arsimor shqiptar filloi në vitin shkollor 2015-2016 dhe faza tranzitore do të përfundojë në vitin shkollor 2019-2020.

NENI 9

Hapja dhe mbyllja e seksioneve dygjuhëshe

Mundësia e hapjes së seksioneve të reja dygjuhëshe do të vendoset me marrëveshje midis Palëve. Propozimi për mbylljen e seksioneve ekzistuese apo për transferimin e seksioneve nga një shkollë në tjetrën, kur funksionimi nuk ka respektuar dhe përmbushur objektivat e parashikuara, i nënshtrohet një Grupi të Përzier Ekspertësh, i ndërtuar nga një numër i njëjtë pjesëtarësh për secilën Palë.

NENI 10

Shpenzimet

Aktivitetet e parashikuara nga ky Memorandum Mirëkuptimi do të zbatohen nga Palët brenda kufijve të burimeve financiare përkatëse pa pagesa shtesë për buxhetet e zakonshme të Republikës Italiane dhe të Republikës së Shqipërisë.

NENI 11

Modalitetet e ndryshimit dhe rishikimit

Palët bien dakord të kryejnë periodikisht vlerësimin e funksionimit të seksioneve dygjuhëshe sipas parashikimit të këtij Memorandumi, edhe me qëllimin për të mundësuar ndryshime, përditësime dhe përmirësime. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet në çdo moment, me shkrim, me mirëkuptimin e Palëve.

NENI 12

Mosmarrëveshjet

Çdo mospërputhje që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet përmes konsultimeve dhe negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet Palëve.

NENI 13
Efektiviteti dhe kohëzgjatja

Ky Memorandum do të marrë vlerë nga data e nënshkrimit prej Palëve dhe do të ketë një kohëzgjatje prej shtatë vjet dhe do të konsiderohet heshtazi i rinovuar për një kohë të njëjtë, përveç rastit nëse njëra Palë njofton Palën tjetër lidhur me qëllimin e saj për ta ndërprerë atë, gjashtë muaj para datës së përfundimit.

Duke nisur nga data e nënshkrimit ky Memorandum zëvendëson Memorandumin e Mirëkuptimit mbi funksionimin e Seksioneve Dygjuhëshe të datës 14 janar 2011 dhe Adendumit të tij të datës 7 korrik 2011.

Nënshkruar në Tiranë, më 10.12.2019, në dy originalë, secili në shqip dhe italisht, të gjitha tekstet të besueshme në të dyja gjuhët.

**Për Ministrinë e Arsimit, Sportit
dhe Rinisë të
Republikës së Shqipërisë**

Besa SHAHINI

Ministër



**Për Ministrinë e Punëve
të Jashtme e Bashkëpunimit
Ndërkombëtar të
Republikës së Italisë**

Alberto CUTILLO

Ambasador



Dokumente të Bashkëngjitura

A = Plani mësimor;

B = Programet mësimore për lëndët;

C = Sistemi i vlerësimit;

D = Kuadri i Përbashkët European i Referencave për Gjuhët –Nivelet e përbashkëta të referimit: Shkalla Globale;

E = Shkollat, vendndodhja e seksioneve.